



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:224459
Datë: 18.10.2024
Numri i dokumentit: 06318195

A.nr.2516/22

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Rajmonda Kurteshi, në konfliktin administrativ të paditësit R.S nga fshati N..., Komuna Ferizaj, të cilin e përfaqëson I.A, avokat nga Gjilani, sipas autorizimit, kundër të paditurës Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, me bazë juridike anulimin e vendimit dhe pagesa e pensionit kontributdhënës, jashtë seance, me datë 18.10.2024, mori dhe përpiloi këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET e tërhequr padia e paditësit R.S, kundër të paditurës Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, me bazë juridike anulimin e vendimit dhe pagesa e pensionit kontributdhënës.

A r s y e t i m

Paditësi, me datën 31.10.2022, përmes të autorizuarit të tij në këtë gjykatë, ka parashtruar padi kundër të paditurës Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, me bazë juridike anulimin e vendimit dhe pagesa e pensionit kontributdhënës. Ndërsa me datën 22.01.2024, ka bërë plotësimin dhe korrigjimin e saj.

Gjykata, pas shqyrtimit paraprak të padisë, ka gjetur se paditësi nuk e ka paguar taksën gjyqësore për padi.

Gjykata, me datë 13.02.2024, paditësit përkatësisht të autorizuarit të tij ia ka dërguar vërejtjen për pagimin e taksës gjyqësore në emër të padisë, në shumë prej 50 euro, në adresën e dhënë në shkresat e lëndës, me paralajmërimin se nëse nuk paguhet taksa gjyqësore në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit dhe nuk ekzistojnë kushtet për lirim nga taksa gjyqësore, atëherë gjykata do të merr vendimin me të cilin padia e paditësit do të konsiderohet e tërhequr.

Paditësi, përkatësisht i autorizuari i tij, siç shihet nga fletë kthesa e postës, vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore e ka pranuar me datë 21.02.2024, mirëpo i njëjti nuk ka vepruar sipas vërejtjes dhe nuk e ka paguar taksën gjyqësore, siç parashihet me Udhëzimin Administrativ me nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

Meqenëse paditësi nuk e ka paguar taksën gjyqësore për padi dhe në rastin konkret nuk ekzistojnë konditat për lirim nga pagimi i taksës gjyqësore, gjykata duke u bazuar në nenin 63 të LKA-së, nenin 253.5 të LPK-së dhe nenin 5.5.2 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, i Plotësuar ky me Udhëzimin Administrativ nr.02/2019, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Administrative

A.nr.2516/22, me datë 18.10.2024

Gjyqtarja,
Rajmonda Kurteshi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej pesëmbëdhjete (15) ditëve, pas marrjes së të njëjtit, nëpërmjet kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.